



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë 01.11.2022]

Lënda: Njoftimi i shkurtuar i Kontratës i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë”

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË.

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tel/Faks: 00 355 4 22 56 799
E-mail: administrative.prokurime@tirana.al
Ueb-faqe www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Proçedurë e hapur”

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-48177-11-01-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë”.

5. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **16.666.661 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh**, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

- “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Investim (231)” me tipologji (Sistem Software + pajisje HW) me vlerë të fondit limit 13,333,333 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- “Sistemi elektronik për mbledhjen dhe menaxhimin e informacionit për fermerët në hapësirën territoriale të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji (mirëmbajtje dhe trajnim) me vlerë të fondit limit 3,333,328 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 27 (njëzetë e shtatë) muaj. Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 (tre) muaj nisur nga kjo datë për implementimin e sistemit dhe 24 (njëzetë e katër) muaj pas implementimit të sistemit (duke filluar nga data e marrjes në dorëzim), do të jetë periudha e mirëmbajtjes së tij.

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 17/11/2022; ora 12:00